


Udhëzuesi im rreth kthimit



**Versioni për
fëmijë**

FRONT 



EUROPEAN BORDER AND
COAST GUARD AGENCY

Ne e kemi shkruar këtë libër për ju.

Mund t'ju kenë thënë se duhet të transferoheni dhe të shkoni të jetoni në vendin e origjinës së familjes suaj. Ky libër shpjegon se çfarë mund të ndodhë nga tani dhe kur të mbërrini në shtëpinë tuaj të re. Sa më shumë të dini, aq më i përgatitur do të jeni për këtë ndryshim të madh në jetën tuaj. A keni pyetje rreth udhëtimit për në vendin e origjinës së familjes suaj? Shkruani ose vizatoni një fotografi rreth tyre këtu:

Jo gjithçka që përshkruajmë në këtë libër do të vlejë për ju. Gjërat mund të ndodhin për ju në një mënyrë tjetër.



Ndërsa ndërmerrni këtë udhëtim, do të takoni të rritur, detyra e të cilëve është t'ju ndihmojnë ju dhe familjen tuaj. Nëse ky libër nuk u përgjigjet pyetjeve tuaja, pyesni këta persona ose dikë që ju besoni.


E rëndësishme! - Të drejtat tuaja

Ashtu si të rriturit, edhe fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta. Të drejtat ju ofrojnë atë që ju nevojitet për të mbijetuar dhe zhvilluar, ju mbrojnë nga dhuna dhe diskriminimi dhe ju ndihmojnë të merrni pjesë dhe të dëgjoheni në vendimet që ju prekin juve. Personat nën moshën 18 vjeç



kanë të drejta të veçanta dhe këto janë të shkruara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Kjo është një marrëveshje e rëndësishme nga vendet që kanë premtuar të mbrojnë të drejtat e të GJITHË fëmijëve. Të gjitha të drejtat janë të lidhura, të gjitha janë të rëndësishme, nuk mund t'ju hiqen dhe ju i keni këto të drejta kudo që shkoni. Në faqen tjetër mund të gjeni posterin e UNICEF-it me të drejtat.

Mund t'i gjeni të gjitha ato këtu me më shumë informacion



 <p>18 DEFINITION OF A CHILD</p>	 <p>2 NO DISCRIMINATION</p>	 <p>3 BEST INTERESTS OF THE CHILD</p>	 <p>4 MAKING RIGHTS REAL</p>	 <p>5 FAMILY GUIDANCE AS CHILDREN DEVELOP</p>	 <p>6 LIFE, SURVIVAL AND DEVELOPMENT</p>	 <p>7 NAME AND NATIONALITY</p>
 <p>8 IDENTITY</p>	 <p>9 KEEPING FAMILIES TOGETHER</p>	 <p>10 CONTACT WITH PARENTS ACROSS COUNTRIES</p>	 <p>11 PROTECTION FROM KIDNAPPING</p>	 <p>12 RESPECT FOR CHILDREN'S VIEWS</p>	 <p>13 SHARING THOUGHTS FREELY</p>	 <p>14 FREEDOM OF THOUGHT AND RELIGION</p>
 <p>15 SETTING UP OR JOINING GROUPS</p>	 <p>16 PROTECTION OF PRIVACY</p>	 <p>17 ACCESS TO INFORMATION</p>	 <p>18 RESPONSIBILITY OF PARENTS</p>	 <p>19 PROTECTION FROM VIOLENCE</p>	 <p>20 CHILDREN WITHOUT FAMILIES</p>	 <p>21 CHILDREN WHO ARE ADOPTED</p>
 <p>22 REFUGEE CHILDREN</p>	 <p>23 CHILDREN WITH DISABILITIES</p>	 <p>24 HEALTH, WATER, FOOD, ENVIRONMENT</p>	 <p>25 REVIEW OF A CHILD'S PLACEMENT</p>	 <p>26 SOCIAL AND ECONOMIC HELP</p>	 <p>27 FOOD, CLOTHING, A SAFE HOME</p>	 <p>28 ACCESS TO EDUCATION</p>
 <p>29 AIMS OF EDUCATION</p>	 <p>30 MINORITY CULTURE, LANGUAGE AND RELIGION</p>	 <p>31 REST, PLAY, CULTURE, ARTS</p>	 <p>32 PROTECTION FROM HARMFUL WORK</p>	 <p>33 PROTECTION FROM HARMFUL DRUGS</p>	 <p>34 PROTECTION FROM SEXUAL ABUSE</p>	 <p>35 PREVENTION OF SALE AND TRAFFICKING</p>
 <p>36 PROTECTION FROM EXPLOITATION</p>	 <p>37 CHILDREN IN DETENTION</p>	 <p>38 PROTECTION IN WAR</p>	 <p>39 RECOVERY AND REINTEGRATION</p>	 <p>40 CHILDREN WHO BREAK THE LAW</p>	 <p>41 BEST LAW FOR CHILDREN APPLIES</p>	 <p>42 EVERYONE MUST KNOW CHILDREN'S RIGHTS</p>

43-54

 HOW THE CONVENTION WORKS

CONVENTION ON THE RIGHTS OF THE CHILD

1. Kur dëgjoni për vendimin e kthimit

Vendi ku po qëndroni, si çdo vend, ka ligje dhe rregulla. Vendimet merren nga autoritetet e vendit në bazë të këtyre ligjeve dhe rregullave. Për ju dhe familjen tuaj tani nuk ka mundësi të qëndroni dhe të jetoni këtu. Mjerisht, edhe nëse dëshironi të qëndroni këtu, kjo nuk është e mundur për momentin. Kjo do të thotë që ju duhet të ktheheni në vendin e origjinës së familjes suaj.

Ky është një ndryshim i madh. Ju mund të mos e mbani mend vendin e origjinës së familjes suaj. Mund të ndiheni i trishtuar të largoheni nga miqtë ose nga shkolla. Ju mund të jeni i shqetësuar për lëvizjen dhe i pasigurt se si do të jetë jeta juaj më pas.



Ose ndoshta jeni i gëzuar që do të shihni miqtë dhe familjen nga vendi i origjinës së familjes suaj dhe i emocionuar për këtë ndryshim të madh. Të gjitha këto ndjenja janë normale.

Ndonjëherë është e dobishme të ndani ndjenjat tuaja me dikë tek i cili keni besim. Nëse ndiheni komod, mund t'u tregoni atyre çfarë keni shkruar.



2. Dokumentet e identifikimit dhe udhëtimit

Për të udhëtuar ju duhet një pasaportë. Nëse nuk keni pasaportë, qeveria e vendit të origjinës së familjes suaj do t'ju përgatisë një të tillë. Ju ose do të merrni pasaportën tuaj ose do të përfshiheni në pasaportën e prindit tuaj.



Një person nga qeveria e vendit të origjinës së familjes suaj mund të takohet me ju për të kontrolluar nëse informacioni për pasaportën tuaj është i saktë. Ky person mund të pyesë për emrin tuaj, ku keni lindur dhe vendet ku keni jetuar. Ai mund të flasë në një gjuhë të vendit të origjinës së familjes suaj.



3. Ku qëndroni përpara se të udhëtoni

Përpara se ju dhe familja juaj të ktheheni në vendin tuaj të origjinës, mund t'ju duhet të qëndroni në një ndërtesë me familje të tjera që presin të udhëtojnë. Ju dhe familja juaj do të qëndroni së bashku. Ju do të merrni ushqim për të ngrënë dhe kujdes mjekësor kur jeni i sëmurë ose i lënduar. Ju do të qëndroni këtu derisa të udhëtoni. Ju mund të lejoheni ose jo të dilni nga ndërtesa ose t'ju vizitojnë njerëzit që jetojnë jashtë. Ka rregulla të ndryshme në vende të ndryshme.





4. Udhëtimi për në aeroport

Kur të jetë koha për të udhëtuar, ju dhe familja juaj do të udhëtoni së bashku në vendin e origjinës së familjes suaj me avion. Një furgon do t'ju çojë ju dhe familjen tuaj në aeroport. Në furgon do të ketë vende të veçanta për fëmijët më të vegjël. Një ose disa persona, të quajtur shoqërues mund të hyjnë në furgon me ju. Nëse po, këta shoqërues mund të veshin një jelek të veçantë që ju t'injihni. Detyra e tyre është t'ju ndihmojnë. Kjo është puna e tyre. Ju mund t'u bëni atyre pyetje.





Çfarë ngjyre mendoni se do të jetë jeleku?



5. Në aeroport

Në aeroport duhet të tregoni pasaportat tuaja në sportelin e regjistrimit. Këtu ju lini bagazhet tuaja të mëdha. Ato do të udhëtojnë në fund të avionit. Ju mund të merrni një bagazh të vogël me vete në avion. Pas regjistrimit do të kaloni kontrollin e sigurisë. Ata do të kontrollojnë bagazhet e të gjithëve, gjithashtu lodrat dhe librat që dëshironi të sillni në avion. Mund t'ju duhet t'i tregoni pasaportat nëpunësit doganor. Ju do të prisni së bashku me familjen tuaj në aeroport. Kur avioni të jetë gati për t'u nisur, ju do të hipni në avion si familje dhe do të uleni së bashku. Një shoqërues mund të presë me familjen tuaj. Ju mund t'u bëni atyre pyetje. Nëse ka diçka që ju nevojitet, ata mund të jenë në gjendje t'ju ndihmojnë.






6. Në avion

Në avion, ju do të uleni së bashku me familjen tuaj dhe njerëz të tjerë që po udhëtojnë në të njëjtin destinacion.

Rregullat e bagazheve të dorës



Rregullat për lëngjet



Mund t'ju shërbehet një vakt dhe pije dhe mund të jeni në gjendje të shikoni një video në ekran. Ka një tualet në avion.

Stjuardesat do t'ju ndihmojnë nëse keni nevojë për ndonjë gjë dhe do t'ju japin udhëzime se çfarë të bëni për të qenë i sigurt, si p.sh. të lidhni rripin e sigurimit.

Është një ide e mirë të sillni lodra, një libër ose lojëra në bagazhin tuaj të dorës që të mund të luani me to gjatë fluturimit. Mund t'ju duhet të merrni vetëm një avion, ose mund t'ju duhet të ndaloni në një aeroport tjetër dhe të ndërroni avionin për të arritur në destinacionin tuaj.





7. Mbërritja

Kur të mbërrini në vendin e origjinës së familjes suaj, do të dilni nga avioni si familje. Ju duhet të prisni për bagazhet tuaja. Një person mund t'ju ndihmojë të udhëtoni nga aeroporti drejt vendit ku do të qëndroni. Familja juaj mund të marrë ndihmë nga një organizatë për t'ju mbështetur.



8. E ardhmja

Tani që jeni në vendin e origjinës së familjes do të përjetoni gjëra të reja dhe të ndryshme. Si p.sh. një shtëpi të re, një shkollë të re, një gjuhë tjetër dhe ushqime të ndryshme.

E reja është gjithmonë emocionuese, prandaj mos kini frikë të zbuloni gjëra të reja, ndoshta një mësues të ri të këndshëm, të gjeni miq të rinj të sjellshëm dhe disa ëmbëlsira të reja të mira.

Kjo jetë e re gjithashtu mund t'ju bëjë të ndiheni i trishtuar, i zemëruar ose i shqetësuar. Të gjitha këto ndjenja janë normale. Dhe do të duhet pak kohë për t'u mësuar, kjo është e natyrshme. Por mos harroni se familja juaj është atje dhe ata mund t'ju ndihmojnë. Nëse ndiheni komod, ju lutemi tregojini se si ndiheni dikujt tek i cili ose e cila keni besim dhe e doni.





**Për komente rreth librave,
ju lutemi na kontaktoni në
adresën:
frontex@frontex.europa.eu**

FRONT^{EX}

 EUROPEAN BORDER AND
COAST GUARD AGENCY

Plac Europejski 6
00-844 Warsaw Poland
T +48 22 205 95 00
F +48 22 205 95 01

frontex@frontex.europa.eu
www.frontex.europa.eu

Book TT-08-23-070-EN-C
ISBN 978-92-9467-687-0
doi: 10.2819/448343

PDF TT-08-23-070-EN-N
ISBN 978-92-9467-691-7
doi: 10.2819/550838

© European Border and Coast Guard Agency 2023

Ky publikim është vetëm për efekt informimi. As Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare (Frontex) dhe asnjë person që vepron në emër të Frontex nuk është përgjegjës për ndonjë keqpërdorim të mundshëm të informacionit që përmban ky publikim.

